



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	02.10.2025
Referencë	11-344/9
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-shtator

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit shtator Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- gjatë muajit shtator në fokus ishin inspektimi i lokaleve afariste. Janë realizuar urdhëresa për regjistrim të lokaleve dhe urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste. Gjithsejtë gjatë muajit janë realizuar 8 pranime teknike të lokaleve afariste.

Pjesë e agjendës së inspektorëve të tregut ka qenë inspektimi i marketeve. Është kontrolluar për çmimin e artikujve, përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë si dhe vendosjen e flamujve të cilët tregojnë origjinën e mallit.

Janë shqyrtuar ankesat e konsumatorëve ku gjatë blerjeve janë hasur në parregullsi.

Në vazhdimësi janë inspektuar tregjet: tregu i gjelbër, tregu i mobileve dhe ai i kafshëve.

Inspektori i ambientit-mjedisit- është përgjigjur në ankesat e qytetarëve të bëra me shkrime dhe në mënyrë verbale, ku ankesat ishin të ndryshme si: mbyllje të rrjetit të kanalizimit gjatë kryerjes së punimeve të ndryshme nga firma ndërtimore, pastaj dëmtim të gypit të rrjetit kryesor të kanalizimit të fshatrave Gllavic dhe Marevc nga KEDS gjatë vendosjes së shtyllave të rrjetit elektrik si dhe ankesa tjera për ndezje të mbeturinave nga disa qytetarë në fshatrat Banullë dhe Vogoqinc, pastaj pengesa në qytet si pasojë e vendosjes së klimave. Të gjitha rastet janë shqyrtuar, dhe janë dhënë urdhëresa për mënjanimin e parregullsive, disa urdhëresa janë zbatuar menjëherë, por ka edhe që janë duke u pritur afatet e për ri-kontrollë

Janë bërë kontrolla tek deponit e mbeturinave afër guroveve në fshatin Gadime e Ulët, pastaj rruga që të dërgon në fshatin Akllap nga fshati Sllovi për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen apo gjeten dëshmi për mbeturinat hedhura.

Është bërë kontroll tek objektet që janë pajisur me leje mjedisore komunale, në lidhje me zbatimin e kushteve për ruajtjen e mjedisit gjatë ndërtimit

Inspektorët e trafikut- gjatë muajit janë inspektuar firma të autobusëve, auto taksit, radio taksit; firmat e autobusëve janë inspektuar për licenca, çertifikata të autobusëve dhe për rende të udhëtimit se a janë të pajisur si dhe a janë duke e respektuar rendin e udhëtimit ku disa prej tyre i janë dhënë vërejtje që t'i respektojnë në vazhdimësi rendin e udhëtimit dhe të mos ketë vonesa ndërmjet rendeve të udhëtimit

Janë bërë inspektime në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” me objektivë kontrolli i kompanive radio-taksi dhe taksiv ilegal të cilët merrnin pasagjer pa porosi që është në kundërshtim me Ligjin.

Në qytet kemi inspektuar auto-taksit ku kemi pasur ankesa nga firmat e autobusëve se po na pengojnë, të cilët i kemi kontrolluar dhe i kemi urdhëruar që mos ndërhyhet në rendet e udhëtimit të firmave të autobusëve sepse jemi të detyruar që të mirren masa sipas ligjit.

Është mbajtur takim me përfaqësuesit e KEDS në lidhje me punimet të cilat janë zhvilluar për vendosjen e rrjetit elektrik nga kompania e kontraktuar nga KEDS në disa rrugë të fshatrave Poturoc, Torin, Dobraj të cilat janë bërë prerje të asfaltit, si dhe për vendosjen e shtyllave të betonit në hapësirat e gjelbëruar ku janë urdhëruar që rrugët të asfaltohen dhe shtyllat e betonit të largohen nga hapësira e gjelbër.

Inspektori i ndërtimit-Përgjatë muajit shtator inspektori i ndërtimitarisë ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në teren, e sidomos përgjatë zonës urbanistike, industriale, ekonomike. Me procesverbal është evidentua dhe konstatuar për të gjitha ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi. Ndaj ndërtimeve pa leje sipas raportit të inspektorit janë realizuar të gjithë hapat procedural ligjor.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjbur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në formë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit shtator janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike të lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Gjoha mandatore.

Aktvendime.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Kontrolla për leje Mjedisore komunale	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoha mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Kallëzim penal	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	156	21	8						68	19				175€	9	12	12			7
Ambienti	23	7			2	2			12											
Ndërtimi	35	12			8		2			12			1							
Trafiku	64	7						33	9							10			5	
Gjithsej	278	47	8		10	2	2	33	89	31			1	175€	9	22	12		5	7

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.